Taksa e Pullës
u Pagua

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ANILA I. ÇELAJ**
**ADRESA RR. E ELBASANIT, NR.27**
**TEL: 694119943**

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

**Nr. repertori: 4768** **Nr. koleksioni: 1017**

**Tirane më 09/07/2021**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

A2021050380107839256

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë

A2021050380107839256

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI**

Sot, më datë 28/07/2021, para meje Notere ANILA I. ÇELAJ, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR. E ELBASANIT, NR.27, u paraqit personalisht:

**SHITËS**:
Gëzim Pani, atësia Besnik, amësia Suzana, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Faik Konica; Nd. 6; H. 12; Ap. 20; Njësia Administrative Nr. 2; Njesia Bashkiake Nr. 2; 0000; Tiranë, lindur më 22/08/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033977605 dhe nr. personal H80822036L.

**SHITËS**:
Arbër Saliaj, atësia Ethem, amësia Dituri, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Rr,Arkitekt Kasemi; Njësia Administrative Nr. 3; 0000; Tiranë, lindur më 26/02/1986, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036629368 dhe nr. personal I60226066K.

**BLERËS**:
Shoqëria "CHICKEN FARM ALBANIA" sh.p.k, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L33431801N, me adresë Agonas, përfaqësuar nga Administratori Marenglen Meqemeja, atësia Ahmet, amësia Nadja, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë Naim Frasheri; Nd. 84; H. 2; Ap. 45; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 10/07/1978, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037289247 dhe nr. personal H80710075O.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë **"Chicken House" shpk**., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**KUSHTE PARAPRAKE:**

- **Shoqëria "Chicken House" shpk** është person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 08.01.2020 dhe e pajisur me NIPT- M01308011J;

- **Z. Gëzim Pani**, ortak i shoqërisë "Chicken House" shpk, zotëron 1 (një) kuotë në kapitalin themeltar të shoqërisë, e cila përfaqëson 25 % (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar në shoqërinë "Chicken House" shpk, e regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;

A2021050380107839256

- **Z. Arbër Saliaj**, ortak i shoqërisë "Chicken House" shpk, zotëron 1 (një) kuotë në kapitalin themeltar të shoqërisë, e cila përfaqëson 25 % (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar në shoqërinë "Chicken House" shpk, e regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar;

- **Z. Gëzim Pani** dhe **Z. Arbër Saliaj** shprehin dëshirën për të shitur kuotat respektive që ata zotërojnë në shoqërinë **"Chicken House" shpk** dhe shoqëria **"Chicken Farm Albania" shpk**, e përfaqësuar nga **Z. Marenglen Meqemeja**, shpreh dëshirën dhe miratimin e saj për të blerë kuotat e ofruara nga ta.

Bazuar në sa më sipër, *Palët* kanë ranë dakord që të hartojnë këtë Kontratë me kushtet dhe afatet e mëposhtme:

## NENI 1
## OBJEKTI I KONTRATËS

1.1 *Shitësit* do të transferojnë te *Blerësi* nëpërmjet shitjes 2 (dy) kuota që ata zotërojnë te shoqëria "Chicken House" sh.p.k, të cilat përfaqësojnë 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të saj, sipas Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme, datë 28.07.2021, bashkangjitur kësaj Kontrate, respektivisht:

1.1.1. Transferimin te *Blerësi* nëpërmjet shitjes së 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Chicken House" shpk, të regjistruar me vlerë nominale prej 2 500 (dymijë e pesëqind) Lekë, e zotëruar nga ortaku Z. Gëzim Pani;

1.1.2. Transferimin te *Blerësi* nëpërmjet shitjes së 1 (një) kuote, e cila përfaqëson 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Chicken House" shpk, të regjistruar me vlerë nominale prej 2 500 (dymijë e pesëqind) Lekë, e zotëruar nga ortaku Z. Arbër Saliaj.

1.2 *Blerësi* pranon të blejë 2 (dy) kuota të zotëruara nga *Shitësit,* të cilat përfaqësojnë 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Chicken House" shpk, sipas vullnetit të shprehur të tij;

1.3 Pas këtij transferimi, pjesëmarrja në kapitalin e shoqërisë "Chicken House" sh.p.k do të jetë si më poshtë:

- **Shoqëria "Chicken Farm Albania" sh.p.k.**, person juridik shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 31.10.2013, me NIPT- L33431801N, përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë **Z. Marenglen Meqemeja**, shtetas shqiptar, lindur më 10.07.1978, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: H80710075O, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, do të zotërojë 1 (një) kuotë, e cila përfaqëson 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Chicken House" shpk.

A202105038010783925 6

## NENI 2
## ÇMIMI I KONTRATËS

2.1. Secila prej kuotave të sipërmendura do të transferohet nga *Shitësit* te *Blerësi* në vlerën prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) Lekë secila prej tyre.

2.1 *Shitësit* i transferojnë *Blerësit* 2 (dy) kuota, ku secila nga kuotat përbën 25 % (njëzet e pesë përqind) të pjesëve të kapitalit të shoqërisë "Chicken House" shpk, me vlerë shitje prej 2 500 (dy mijë e pesëqind) Lekë secila prej tyre dhe së bashku përfaqësojnë 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë "Chicken House" shpk, me vlerë totale shitje prej 5 000 (pesë mijë) Lekë;

2.2 Çmimi i kontratës do të paguhet cash nga *Blerësi* te *Shitësit* nga momenti i nënshkrimit të kësaj Kontrate nga Palët.

## NENI 3
## TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

3.1 *Shitësit* garantojnë *Blerësin* se pjesët e kapitalit janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë dhe hipotekë, në përputhje me Vërtetimin përkatës të lëshuar nga Regjistri i Barrëve Siguruese.

## NENI 4
## MOSMARRËVESHJET

4.1 Çdo konflikt apo mosmarrëveshje në lidhje me keqinterpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nga *Palët*, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

## NENI 5
## TË NDRYSHME

5.1 Kjo Kontratë është hartuar në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore;

5.2 Kontrata është hartuar në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe do të interpretohet sipas këtij legjislacioni;

5.3 Kjo Kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

Unë, Noterja, pasi u binda për identitetin e *Palëve*, aftësinë e tyre për të vepruar dhe pasi ju lexua përmbajtja e kësaj Kontrate me zë të qartë, konstatova se ajo është hartuar në përputhje me qëllimin dhe shpreh vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, *Palët* e nënshkruan përpara meje rregullisht dhe Unë, Noterja e vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave Personale"*, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj Kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

A2021050380107839256

**PALËT**

**SHITËSIT:**

**Z. Gëzim Pani**

**Z. Arbër Saliaj**

**BLERËSI:**

**Shoqëria "Chicken Farm Albania"shpk**

**Përfaqësuar nga:**

**Z. Marenglen Meqemeja**

CHICKEN FARM ALBANIA Sh.p.k.
Nipt:L33431801N
KAVAJE - ALBANIA

**NOTERE**

ANILA I. ÇELAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ANILA I. ÇELAJ
NOTER
TIRANË

Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-2021070613246653 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 06.07.2021 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 1:02:46PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-608-2716 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

GEZIM BESNIK PANI
CHICKEN HOUSE SH.P.K.
ARBER ETHEM SALIAJ

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANE - ALBANIA